

## Programi i tregtisë dhe i administrimit

A dëshiron të keshë shumë kontakte me njëri-tjetër gjatë punës?

A dëshiron të kërkesësh punë menjëherë pas gjimnazit?

A dëshiron të keshë mundësi të punosh dhe të studiosh jashtë vendit?

A dëshiron të mësosh më tepër në lidhje me një lëmi që rritet dhe që ndryshon?

A dëshiron të nisësh sipërmarrjen tënde në ardhmëri?

Në atë rast, Programi i tregtisë dhe i administrimit mund të jetë për ty.

Te Programi i tregtisë dhe i administrimit të jepet mundësia e diturive të gjëra për shitje, shërbim dhe turizëm. Këto lëmi janë të mëdha dhe ndikojnë shumë lloje të ndryshme të lëmvive dhe të punëve tjera. Do të mësosh si të pranosh blerësit dhe se si të konsiderosh dëshirat dhe nevojat e ndryshme të njëzve. Do të mendosh edhe për çështje aktuale siç janë ndikimi ambiental dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Nëse dëshiron të punosh me tregti apo udhëtime do të hasesh me lëminë ndërkombëtare. Me dituri gjuhësore dhe me kuptim e interesim për kulturat tjera, do të kesh mundësi të mira që të punosh dhe studiosh jashtë vendit pas përfundimit të kohës tënde te Programi i tregtisë dhe i administrimit.

## Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse zgjedh Programin e tregtisë dhe të administrimit mund të kërkesësh punë menjëherë pas gjimnazit. Llojet e punëve ku mund të pranohesh varren nga drejtimi që e ke zgjedhur dhe nga kurset që i ke ndjekur. Mund të studiosh në fakultet ose të zgjedhësh një kualifikim tek Fakulteti i profesioneve ose në një fakultet apo universitet. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve se cilat kurse do të duhet t'i zgjedhësh që të jesh me kompetencë për aplikimin.

## Punë ku mund të pranohesh

Pasi që ke studijuar te Programi i tregtisë dhe i administrimit, do të mundesh për shembull të kërkesësh punë si shitës, punëtor në shitore, udhëheqës i udhëtimieve ose shoqërues turistësh.

## Përmbajtja e Programit

Programi i tregtisë dhe i administrimit përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurset e tjera janë veçanta për Programin e tregtisë dhe i administrimit. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi përbëhet prej dy drejtimeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë në Programin e tregtisë dhe të administrimit në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimet. Në disa vende mund të ketë edhe më tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve!

Drejtimit kombëtare janë:

- Tregti dhe shërbime – për ty dëshiron të punosh ne butiqe, ose duke shitur mallra në shitore
- Turizëm dhe udhëtime – për ty dështon të punosh në agjenci udhëtimesh, si shoqërues, me informacion turistik ose ne hotele.

## **Kontake me tregun e punës**

Te Programi i tregtisë dhe i administrimit do të kesh kontakte me tregun e punë që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Kjo është një mënyrë e mirë që të krijoni kontakte të cilat mund t’i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t’ju jepet.

## **Ardhmëri dhe punë**

Ka nevojë të madhe për personel në tregti. Nëse dëshiron të punosh me shitje apo në butiqe, ndoshta do të jetë me e lehtë të punësoshesh pasi që t’i përfundosh studimet te Programi i tregtisë dhe i administrimit. Nëse dëshiron të punosh me turizëm apo administrim, mund të ndoshta që të bëhet më e vështirë. Sasia e punëve të atij llojit nuk është aq e madhe dhe ka shumë që i kërkojnë pikërisht ato lloje punësh.